

UDHËZIM
Nr. 456, datë 26.10.2021

PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR. 713, DATË 11.10.2018,
“PËR TARIFAT E LICENCIMIT TË VEPRIMTARIVE, TË CILAT PËRDORIN
BURIME TË RREZATIMIT JONIZUES”

Në zbatim të nenit 7, germa “a”, të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 713, datë 11.10.2018, “Për tarifat e licencimit të veprimtarive, të cilat përdorin burime të rrezatimit jonizues”, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 1 të udhëzimit shtohen pika 1/1 dhe pika 1/2, me përmbajtjen si vijon:

“1/1. Tarifat e përcaktuara në këtë udhëzim janë për çdo burim ose pajisje për të cilin realizohet ekspertizë.

1/2. Për procedurën e rilicencimit të veprimtarive që nuk kanë ndryshim në ekspertizën e kryer, paguhet gjysma e tarifës së përcaktuar për licencimin e veprimtarisë.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu